



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI CIVIL**

**Nr. 01757-2010 i Regj. Themeltar
Nr. i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

Besnik Imeraj	- Kryesues
Gani Dizdari	- Anëtar
Andi Çeliku	- Anëtar
Medi Bici	- Anëtar
Fatos Lulo	- Anëtar

Në datën 14/06/2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen civile me nr. 01757-2010 akti, që u përket palëve:

PADITËS:

- 1. Ana Mitro (Veveçka),** e bija e Jorgjit, e vtl.1937, banuese në Durrës.
- 2. Fotaq Konomi,** i biri i Ksenofonit, i vtl.1937, banues në Vlorë.
- 3. Vasillaq Goxhomani,** i biri i Kristaqit, i vtl.1932, banues në Berat.
- 4. Eleni Mima,** e bija e Konstandinit, e vtl.1946, banuese në Tiranë.

**NDËRHYRËS
KRYESOR:**

- 1. Polikseni Mima,** e bija e Konstandinit, banuese në Athinë.
- 2. Marjeta Mima,** e bija e Vasilit, e vtl.1953, banuese në Tiranë.

TË PADITUR:

Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave.

Zyra Rajonale e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave, Qarku Durrës.

OBJEKTI:

-Ndryshimi i vendimeve:

1) Nr.384, dt.04.01.2008, ZRKKP të Qarkut Durrës dhe nr.1070, dt.24.09.2008 të AKKPronave Tiranë, duke njohur të drejtën e pronësisë dhe duke kthyer në natyrë, një tokë me sipërfaqje 1.575.900 m².

2) Nr. 380, dt.28.12.2007 të ZRKKK Pronave të Qarkut Durrës dhe nr.1069, dt.24.09.2008, të AKKPronave Tiranë, duke njohur të drejtën e pronësisë dhe kthyer në natyrë, një tokë me sipërfaqje 1.820.000 m².

3) Nr.379, dt.28.12.2008, ZRKK Pronave të Qarkut Durrës dhe nr.1071, dt.24.09.2008, të AKKPronave Tiranë, duke njohur të drejtën e pronësisë dhe duke kthyer në natyrë, një tokë me sipërfaqje 25.597.200 m².

BAZA LIGJORE:

Nenet 18/1, 3 i ligjit nr.9235, dt.29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave", i ndryshuar, nenet 32, 202, 206/b të K.Pr.Civile.

Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr.2653, dt.05.10.2009 ka vendosur:

"-1- Pranimin e kërkesë padisë së paditësave, Ana Mitro (Veveçka), Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomani, Eleni Mima dhe të ndërhyrësave kryesorë, Polikseni Mima e Marjeta Mima.

2- Ndryshimin e Vendimit **Nr. 384, date 04.01.2008** të Zyrës Rajonale të Kthimit Kompesimit Pronave të Qarkut Durrës dhe Vendimit **Nr. 1070, date 24.09.2008** të Agjensisë së Kthimit Kompesimit Pronave Tiranë, si më poshtë:

a) U njihet e drejta e pronësisë trashëgimtarëve ligjorë të ish pronarëve, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Konstandin Mima, Evdhoqia Goxhomani, Ariadhni Konomi dhe Sllava Ljubica Maria Amalia Llampo, mbi një sipërfaqe toke **1.575.900 m²** (157.59 ha), prona "A" e ndodhur në fshatin **Hamallaj** Durrës, Zona Kadastare Nr.1925, Indeksi i hartës K - 34 - 88 - (144 - B, 129 - A, 129 - B), e kufizuar:

Veri - Pasuria Nr.20/1, 21/9

- Jug - Vija ndarëse e fshatit Rrushkull
- Perëndim - Bregu i detit Adriatik
- Lindje - Pasuria Nr.134 (kanal)

(e pasqyruar me ngjyrë rozë në hartën që i bashkëngjitet aktit të ekspertimit).

Nga kjo sipërfaqe:

b) U kthehet në natyrë sipërfaqja e lirë 1.507.500 m² (150.75 ha), e ndodhur brenda pronës "A" me kufizimet:

- Veri - Pasuria Nr.20/1, 21/9
- Jug - Vija ndarëse e fshatit Rrushkull
- Perëndim - Bregu i detit Adriatik
- Lindje - Pasuria Nr.134 (kanal)

(e pasqyruar me ngjyrë rozë në hartën që i bashkëngjitet aktit të ekspertimit).

c) U Kompesohet sipërfaqja e zënë 68.400 m² (6.84 ha), në bazë të nenit 11/15 të ligjit Nr.9235, datë 29.07.2004 i ndryshuar.

3- Ndryshimin e vendimit Nr.380, date 28.12.2007 të Zyrës Rajonale të Kthimit Kompesimit Pronave të Qarkut Durrës dhe Vendimit Nr.1069, datë 24.09.2008 të Agjensisë së Kthimit Kompesimit Pronave Tiranë, si më poshtë:

a) U njihet e drejta e pronësisë trashëgimtarëve ligjor të ish pronarëve, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Konstandin Mima, Evdhoqia Goxhomani, Ariadhni Konomi dhe Sllava Ljubica Maria Amalia Llampo, mbi një sipërfaqe toke 1.647.000 m² (164.70 ha), prona "B", e ndodhur në fshatin Hamallaj Durrës, Zona Kadastare - Nr. 1925, Indeksi i hartës-K - 34 - 88 (144 - B, 146 - A, 129 - D, 161 - B), e kufizuar:

- Veri - Pasuritë Nr. 20/1, 133/2
- Jug - Vija ndarëse e fshatit Rrushkull
- Perëndim - Pasuria 134 (kanal)
- Lindje - Pasuritë Nr.133/2, 137, 49, 146, 187

(e pasqyruar me ngjyrë portokalli në hartën që i bashkëngjitet aktit të ekspertimit).

Nga kjo sipërfaqe:

b) U kthehet në natyrë sipërfaqja e lirë 1.505.400 m² (150.54 ha) e ndodhur brenda pronës "B" me kufizimet:

- Veri - Pasuritë Nr.20/1, 133/2
- Jug - Vija ndarëse e fshatit Rrushkull
- Perëndim - Pasuria 134 (kanal)
- Lindje - Pasuritë Nr.133/2, 137, 49, 146, 187

(e pasqyruar me ngjyrë portokalli në hartën që i bashkëngjitet aktit të ekspertimit).

c) U Kompesohet sipërfaqja e zënë 144.200 m² (14,42 ha) në bazë të nenit 11/15 të ligjit Nr.9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e Pronave" i ndryshuar.

4- Ndryshimin e Vendimit Nr.379, datë 28.12.2007 të Zyrës Rajonale të A.K.K.P.-së të Qarkut Durrës dhe Nr.1071, datë 24.9.2008 të A.K.K.P.-së Tiranë dhe:

a) U njihet e drejta e pronësisë trashëgimtarëve ligjor të ish pronarëve, Jorgji Veveçka, Sofia Kolea, Konstandin Mima, Evdhoqia Goxhomani, Ariadhni Konomi dhe Sllava Ljubica Maria Amalia Llampo, mbi një sipërfaqe toke **22.294.100 m²**

(2229.41ha), prona "C", e ndodhur në fshatin **Rrushkull**, Zona Kadastrale Nr.3241, Indeksi i hartës- e pa përcaktuar pasi zona është jashtë sistemit të Z.V.R.P.P. – Durrës, e kufizuar:

Veri - Pronat "a" dhe "b" dhe pasuria Nr.87/1
Jug - Lumi Erzen dhe pasuritë Nr.138, 134, 137, 130, 41/1, 42/1, 42/2, 45.
Perëndim - Bregu i detit Adriatik
Lindje - Pasuritë Nr.1, 2, 3, 4, 5, 24, 45, 49, 50, 138, 139,140

(e pasqyruar me ngjyrë jeshile në hartën që i bashkëngjitet aktit të ekspertimit).

Nga kjo sipërfaqe:

b) U kthehet në natyrë sipërfaqja e lirë **8.263.500 m² (826,35 ha), e ndodhur brënda pronës "C", me kufizimet:**

Veri - Pronat "a" dhe "b" dhe pasuria Nr.87/1
Jug - Lumi Erzen dhe pasuritë Nr.138, 134, 137, 130, 41/1, 42/1, 42/2, 45.
Perëndim - Bregu i detit Adriatik
Lindje - Pasuritë Nr.1, 2, 3, 4, 5, 24, 45, 49, 50, 138, 139,140

(e pasqyruar me ngjyrë jeshile në hartën që i bashkëngjitet aktit të ekspertimit).

c) U kompesohet sipërfaqja e zënë **14.030.600 m² (140,306 ha) në bazë të nenit 11/15 të ligjit Nr.9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e Pronave" i ndryshuar**

d) Trashëgimtarëve ligjorë të ish pronarëve, Jorgji Veveçka, Sofia Kolea, Konstandin Mima, Evdhoqia Goxhomani, Ariadhni Konomi dhe Sllava Ljubica Maria Amalia Llampo, në bazë të nenit 14 të ligjit Nr.9235, datë 29.07.2004 i ndryshuar, u njihet e drejta e parablerjes për godinat e ndërtuara brenda pronës "C", në rast privatizimi (rep. ushtarak dhe 2 godinat shtetërore).

5- Ligjërimin e masës së sigurimit të padisë, marrë nga Gjykata me vendim të ndërmjetëm në seancë gjyqësore të datës 09.09.2009.

6- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të paditurit."

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.210, dt.14.05.2010 ka vendosur:

"Ndryshimin e vendimit nr.2653 dt.05.10.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Rrëzimin e kërkesë-padisë së paraqitur nga paditësat Ana Mitro, Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomani, Eleni Mima, ndërhyrës kryesorë Polikseni Mima, Marieta Mirna me objekt i padisë dhe ndërhyrjes kryesore: Ndryshimin e vendimeve:

1.Nr.384 dt.4/01/2008, Z.R.K.K.e Pronave të Qarkut Durrës, dhe nr.1070 dt.24/09/2008 te A.K.K.Pronave Tiranë, duke njohur të drejtën e pronësisë dhe duke kthyer në natyrë një tokë me sip. 1575 900 m².

2.Nr.380 dt.28/12/2007, Z.R.K.K.Pronave të Qarkut Durrës dhe nr.1069 dt.24/09/2008, të A.K.K.Pronave Tiranë.

3.Nr.379 dt.28/12/2008 të Z.R.K.K.Pronave të Qarkut Durrës dhe nr.1071 dt.24/09/2008 te A.K.K.Pronave Tiranë, si të pabazuar në ligj e prova.”

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës nr.210, dt.14.05.2010, në mbështetje të nenit 472 të K.Pr.Civile, brenda afatit ligjor, ka paraqitur rekurs pala paditëse Ana Mitro, duke kërkuar prishjen e vendimit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, për këto shkaqe:

-Gjyqtari relator Shkelqim Miri, me vendim të KLD datë 07.05.2010 është transferuar si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë. Seanca gjyqësore në apel është mbajtur më datën 14 Maj 2010. Pra në datën e seancës gjyqësore kur është dhënë ky vendim, gjyqtari Shkelqim Miri nuk ka qenë më gjyqtar i Gjykatës së Apelit Durrës që është gjykata kompetente për shqyrtimin e kësaj çështjeje. Ky fakt është në kundërshtim me parimet që garanton procesi i rregullt ligjor, për arsye se çështja gjyqësore nuk është gjykuar nga një gjykatë kompetente siç parashikon neni 13 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe dispozitat e K.Pr.Civile, neni 4.

-Gjykata e Apelit, riçeli hetimin gjyqësor, kur ky i fundit ishte i panevojshëm pasi gjykata mund të krijonte qartësisht bindjen e vet duke analizuar provat e administruara në proces në shkallë të parë. Edhe pse riçeli hetimin gjyqësor, provat e administruara në apel nuk ishin prova të reja, dhe nuk sillnin fakte të reja.

-Gjykata e Apelit ka interpretuar në mënyrë të gabuar provat e dosjes gjyqësore në kundërshtim me 16 dhe 29 të K.Pr.Civile.

-Gjykata e Apelit arsyeton se paditësat nuk janë subjekte të Ligjit nr.9235, datë 29.07.2004; prona ka qenë e Miltiadh Shallavarit dhe trashëgimlënësat e paditësave nuk rezultojnë pronarë të pronës objekt konflikti, vendimi i gjyqit të paqit të vitit 1946 nuk rezulton se ka marrë formë të prerë dhe ska nënshkrime të sekretarit dhe gjyqtarit të çështjes. Këto përfundime janë plotësisht të gabuara, në kundërshtim me provat e dosjes gjyqësore dhe tregojnë për njëanshmëri të theksuar të gjykatës së apelit në favor të palës së paditur.

-Nga provat e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se trashëgimlënësit e paditësave me vendim të formës së prerë kanë fituar të drejtën e bashkëpronësisë me gruan e M.Shallvarit për pronën objekt konflikti dhe legjitimohen të ngrenë këtë padi në bazë të nenit 32/a të K.Pr.Civile pasi kanë interes të ligjshëm në kërkimet e tyre për tu njohur pronarë e për tu kthyer prona në pronësi të tyre në bazë të Ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar, dhe VKM 747 datë 9.11.2006. Rezulton e provuar se trashëgimtarët e paditësave, kanë pasur cilësinë si ish pronarë dhe se kjo pronë iu është marrë sipas akteve ligjore dhe nënligjore, vendimeve penale të gjykatave ose marrë në çdo mënyrë tjetër nga shteti në datë 29.11.1944. Gjithë sa më sipër është arsyetuar mjaft mirë e në përputhje me provat e dosjes gjyqësore dhe me ligjin në vendimin e shkallës së parë por është rrëzuar në mënyrë absurde, në kundërshtim me ligjin nga Gjykata e Apelit.

-Ligji 9235/2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave", i ndryshuar nuk e lidh aspak dhe asnjëherë, njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës me faktin në se pretenduesit ish pronarë e kanë poseduar apo jo pronën. Të paditurit kanë pasur një pronë e cila deri në vitin 29.11.1944, nuk rezulton të jetë shitur apo tjetërsuar prej tyre. Ky fakt vërtetohet dhe nga nota e transkriptimit të hipotekës Durrës nr.126, dt.29.05.1946 ku prona objekt konflikti që ishte marrë me enfiteozë nga shoqëria EIIA prej znj. Sllava Maria Ljubica Lampo konfiskohet e kalon në favor të shtetit shqiptar. ?

-Por Zj. Lampo nuk ishte pronare e vetme e pronës objekt konflikti pasi siç e kemi sqaruar në pjesën më lart ku pasqyrohen faktet e çështjes, testamenti në bazë të së cilit Zj.Lampo kishte fituar të drejtën e pronësisë për pronën me fjalë u shpall i pavlefshëm me vendim të formës së prerë dhe trashëgimlënësit e paditësave u njohen bashkëpronare të pronës.

-Ky vendim nuk është regjistruar në regjistrat hipotekorë të kohës për arsye se edhe siç është shënuar në dispozitivin e vendimit, regjistrimi në ipotekë në atë kohë pengohej nga zbatimi i Ligjit për Reformën Agrare nr.108, datëe 29.08.1945. Ky vendim përbën një vendim gjyqësor për fazën e parë të pjestimit dhe nuk është vazhduar më ndarjen e pronës në natyrë midis bashkëpronarëve për efekt të zbatimit të ligjit për reformën agrare i cili parashikonte shtetëzimin e të gjitha pronave dhe nuk kishte vend të vazhdohej me pjestimin e pronës në natyrë.

-Ky vendim i Gjyqit të Paqit rezulton të mos jetë ankimuar siç arsyeton drejtë edhe Gjykata e shkallës së parë në vendimin e vet dhe siç konfirmohet nga provat e administruara në dosjen gjyqësore dhe si i tillë konsiderohet se ka marrë formë të prerë.

-Mosregjistrimi i këtij vendimi në regjistrat hipotekorë përkatës të kohës nuk është shkak ligjor për të konkluduar se pala nuk legjitimohet në kërkimet e saj pasi nuk ka interes të ligjshëm siç pretendon ankuesi. Kjo për arsyen e thjeshtë se regjistrimi i

titullit të pronësisë në regjistrat publicë ka vetëm vlerë deklarative, njohëse dhe nuk ka vlerë krijuese.

-Nga një studim i thjeshtë i provave të dosjes gjyqësore rezulton mëse e qartë se prona në fjalë ka qenë pikërisht e familjes Shallvari dhe e regjistruar në origjinë të saj në emër të M.Shallvarit.

-Duke u bazuar në provat e dosjes gjyqësore bashkëpronare të çiftikut Rrushkull janë Maria Ljubica Shallvari, Jorgji Veveçka etj. të përcakruar në vendimin gjyqësor nr.52, datë 2.3.1946 të gjyqit të paqit Durrës, i formuem me kolegji arbitrar nga ku rezulton se testamenti i lënë në favor të bashkëshortes së M.Shallvarit, është i pavlefshëm për arsyet e shpjeguara në atë vendim. Si rrjedhojë bashkëpronarët (trashëgimlënësit e paditësave) e kanë fituar pronësinë në momentin e çeljes së trashëgimisë, në çastin e vdekjes së trashëgimlënësit Miltiadh Shallvari në vitin 1933, e jo në vitin që vendimi i gjykatës së paqit ka marrë formë të prerë.

-Interpretimi që i bën Gjykata e Apelit Ligjit për Aplikimin e Kodit Civil të vitit 1929, kaptina II, neni 55 është i gabuar pasi ky nen bën fjalë për të drejta zotnimi të huajve mbi tokën bujqësore.

-Kjo gjykatë pretendon se prona në momentin që është marrë nga shteti në 1946 ka qenë e shtetit?! Atëherë natyrshëm lind pyetja: Si është e mundur që shteti në vitin 1946 e ka sekuestruar këtë pronë (shih aktin e sekuestrimit, transkriptimin e sekuestrimit në hipotekë), kur nuk qe nevoja ta bënte meqë sipas ankuesit prona rezultonte në pronësi të shtetit.

-E vërteta është që në datën 02.03.1946 është marrë vendimi i gjykatës së Paqit Durrës me të cilën trashëgimlënësat e paditësave janë njohur bashkëpronarë të pronës me M.Lampo, të vënë e M.Shallvarit, ndërkohë që shteti e ka sekuestruar këtë pronë me vonë dhe pasi trashëgimlënësit e paditësave kishin fituar të drejtat e tyre të pronësisë me vendim gjyqësor. Sekuestrimi është bërë në datën 29.05.1946

-Gjykata e Apelit gabon kur arsyeton se toka ka qenë e M.Lampos e cila ka qenë shtetase e huaj dhe e ka mbajtur atë për më shumë se 7 vjet çka do të thoshtë sipas kësaj gjykate që nuk i lejohej sipas ligjit të sipërpërmendur.

-Sqarojmë se M.Lampo ka rezultuar si pronare e pronës në bazë të transkriptimit nr. 527, datë 03.04.1940 të testamentit në hipotekë. Në vitin 1946 është sekuestruar prona dhe afati 7 vjeçar që referon ankuesi në Ligjin; për Aplikimin e Kodit Civil të vitit 1929, kaptina II, neni 55, nuk ka qenë plotësuar. Ndërsa shoqëria e huaj EIIA e ka pasur në posedim pronën dhe jo në pronësi dhe gjithsesi nuk e ka mbajtur për 7 vjet (Kontrata e emfiteozës është transkriptuar në hipotekë në 1940 dhe sekuestrimi nga shteti i pronës është bërë në 1946). Edhe sikur të ishin plotësuar këto afate me çfarë baze ligjore do kalonte prona nga i huaji tek shteti siç pretendon ankuesi? Baza ligjore që citon ankuesi ka të bëjë me një kufizim të së drejtës së zotnimit në atë kohë të tokës bujqësore nga të huajt, por nuk parashikon se kjo e drejtë i kalonte automatikisht shtetit.

-Për sa më sipër, paditësat janë subjekte të Ligjit nr.9234. datë dhe janë trashëgimtarë të ligjshëm të ish pronarëve të pronës së ndodhur në Rrushkull. Për të gjitha sa parashtruam më sipër vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës duhet të prishet.

-Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka zbatuar me përpikmëri normat procedurale duke zhvilluar një proces gjyqësor të rregullt, duke kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm të mosmarrëveshjes midis palëve ndërgjyqëse, duke u bazuar në provat e administruara rregullisht gjatë procesit dhe në ligj dhe vendimi i saj nr.2653 datë 05.10.2009 është i drejtë dhe i bazuar në prova dhe në ligj.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës nr.210, dt.14.05.2010, në mbështetje të nenit 472 të K.Pr.Civile, brenda afatit ligjor, ka paraqitur rekurs pala paditëse Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomani, Eleni Mima, duke kërkuar prishjen e vendimit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, për këto shkaqe:

-Ky vendim ka cënuar të drejtën tonë për një **"proces të rregullt gjyqësor"** dhe na ka **"mohuar të drejtën e pronësisë"**, duke rënë ndesh edhe me një sërë vendimesh të Gjykatës Kushtetuese dhe të **Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut** (Strasburgut).

-**Përbërja e trupit gjykues nuk ka qenë e rregullt.** Këtë konkluzion e nxjerrim nga fakti se **"relatori i çështjes"**, gjyqtari Shkëlqim Miri, ka marrë pjesë në gjykim pa qenë gjyqtar i Gjykatës së Apelit Durrës (sepse ka qenë transferuar në Gjykatën e Apelit Tiranë) dhe pa patur **"autorizim"** nga **KLD-ja**. Këtë shkelje e ngremë, jo thjesht se ndodhemi para një **"shkelje procedurale"**, por sepse **"paligjishmëria e vendimit të dhënë"** të bind se pjesëmarrja e këtij në gjykim ka qenë pikërisht për të dhënë një vendim të paligjshëm.

-**Gjykata nuk ka respektuar dispozitat procedurale që bëjnë fjalë për "vendimet e formës së prerë"**. Konkretisht, këtë qëndrim Gjykata e Apelit e ka mbajtur në raport me Vendimin Nr. 52, datë 2.3.1946 të Gjykatës së Prefekturës Durrës, duke arsyetuar se *ky vendim është trajtuar gabimisht si i mirëqenë, pasi nuk është regjistruar në Hipotekë, nuk ka marrë formën e prerë dhe nuk është nënshkruar nga gjyqtari dhe nga sekretarja e çështjes dhe se gjykimi nuk është zhvilluar nga pronarët e pronës, sepse "de facto" prona ishte marrë nga reforma agrare.*

-Ky vendim, i shpallur në vitin 1946, krahas **"pronësisë"**, ka deklaruar edhe **"pavlefshmërinë e testamentit"** dhe ka njohur trashëgimlënësata tanë si **"trashëgimtarë"** të ish-pronarit Miltjadh Shallvari.

-Gjykata e Apelit arsyeton se **ne nuk mund të përfitojmë nga ligji "Per K.K. e Pronave ish-pronarëve"** sepse prona nuk i është marrë trashëgimlënësave tanë, por personave që rezultojnë pronarë në regjistrat e hipotekës i referohemi

nenit 2 të Ligjit Nr.9235, datë 29.7.2004 "Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave" që ka këtë përmbajtje: "Çdo subjekt i shpronësuar ka të drejtë të kërkojë, në përputhje me këtë ligj, të drejtën e pronësisë, në rast se i është hequr sipas akteve ligjore,...".

-Argumenti i përdorur nga Gjykata e Apelit është se prona nuk ka qenë e jona sepse me ligjet Nr.12, datë 21.10.1943 dhe Nr.36, datë 14.1.1945 "**Mbi konfiskimin e pasurive të shtetasve Italianë dhe gjermanë të ndodhura në Shqipëri**", i është sekuestruar shoqërisë italiane E.I.A.A.

-Gjykata e Apelit ka gabuar sepse të dy këto ligje i ka interpretuar gabim sepse, sipas këtyre janë sekuestruar "**pronat**" e shoqërisë italiane E.I.A.A, por prona e jonë nuk ka qenë asnjëherë pronë e kësaj shoqërie.

-Eshtë e vërtetë se kjo shoqëri e ka përdorur pronën tonë, por në kushtet e "**enfiteozës**", e cila është një kontratë që nuk kalon pronësinë. D.m.th. se prona e jonë nuk ka qenë asnjëherë pronë e huaj (italiane apo gjermane), që të prekej nga ligji i lartpërmendur.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës nr.210, dt.14.05.2010, në mbështetje të nenit 472 të K.Pr.Civile, brenda afatit ligjor, ka paraqitur rekurs ndërhyrësit kryesorë Polikseni Mima dhe Marjeta Mima, duke kërkuar prishjen e vendimit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, për këto shkaqe:

-Nga libri Nr.10-i Kadastrës, faqet 21, 22, 23, 24, datë 19.8.1919, numurat 31 deri në 56 del se të gjitha pronat e kërkuara nga ne kanë qenë të **Miltiadh Shallvarit**, të cilin e kanë trashëguar të gjithë trashëgimlënësit tanë.

-Është e vërtetë se me **testamentin e datës 8.5.1929** ky ja ka lënë këto prona bashkëshortes së tij **Sllava Ljubica Maria Amalia Lamos** dhe deri këtu janë ndalur A.K.K.P.- të, në qark e në qendër, kur kanë konkluduar se prona ka qenë vetëm e kësaj, por ky testament është kundërshtuar për "**pavlefshmëri**" nga trashëgimlënësat tanë dhe Kolegji Arbitror pranë Gjykatës së Prefekturës Durrës, me vendimin **Nr.52, datë 2.3.1946**, duke e pranuar kërkesën, e shpalli "**testamentin absolutisht të pavlefshëm**" dhe njohu si bashkëpronarë të pronave, krahas Maria (Lubica) Shallvarit, edhe trashëgimlënësat tanë, Jorgji Veveçkën, Sofija Kolean, Kostandin Mimen, trashëgimtarët e Evdhoqia Goxhomanit dhe Ariadhni Konomin.

-Sqarojmë se konflikti për pavlefshmërinë e testamentit dhe për njohjen si trashëgimtarë të Miltiadh Shallvarit edhe të trashëgimlënësave tanë ka filluar që në vitin 1933 (e thotë paragrafi i dytë i fletës 2 të vendimit), ndërsa kundërshtimi i testamentit u bë në vitin 1940 (e thotë "Nota e transkriptimit Nr. 465, datë 20.02.1940).

-A ka sjellë ndonjë efekt vendimi **Nr.52, datë 2.3.1946** të Kolegjit Arbitror pranë Gjykatës së Prefekturës Durrës, m.q.s. është vendim i "**fazës së parë të**

pjestimit"? "Po", ka sjellë, dhe për këtë po i referohem Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr.628, date 15.5.2000, i cili, duke trajtuar pikërisht këtë problem, thotë vendimet e fazës së parë të pjestimit, janë vendime të ndërmjetme të një lloji të veçantë (sui generis) kur vendimi i fazës së parë merr formë të prerë, problemet e zgjidhura me të përbëjnë gjë të gjykuar.

-Prona objekt gjykimi nuk është bërë asnjëherë "pronë e shoqërisë italiane":

Së pari, sepse iu është dhënë në "enfiteozë", që nuk ka qenë asnjëherë, dhe nuk është as sot, kontratë me të cilën kalon pronësia, dhe së dyti, se shënimi që ndodhet në fletën 5 të notës së transkriptimit të "kontratës së enfiteozës", duke theksuar se edhe "kjo kontratë" do të konsiderohej e pavlefshme n.q.s. do rezultonte se zotërimi i pronës nuk i takonte i gjithi Sllava Ljubica Maria Amalia Lampos, e konfirmon me së miri pretendimin tonë.

-Si rrjedhojë, nuk ka se si të pranohet që prona objekt gjykimi ka qenë bërë pronë e Italianëve dhe duhet të futet në "grupin e pronave" të shtetëzuara nga Ligji Nr.36, datë 14.1.1945 "Mbi konfiskimin e pasurive të shtetasve Italianë dhe gjermanë të ndodhura në Shqipëri"!

-Është e vërtetë se në transkriptin Nr.126, datë 29.5.1946 thuhet se ... prona transkriptohet në favor të shtetit shqiptar kundër Sh.a. "E.I.A.A.", sipas Ligjit Nr. 36, datë 14.1.1945 "Mbi konfiskimin e pasurive të shtetasve Italianë dhe Gjermanë të ndodhura në Shqipëri", por "de jure" kjo pronë nuk i është konfiskuar kësaj shoqërie, por ish – pronarëve shqiptarë!

-Si konkluzion themi se edhe ky argument i A.K.K.P. - ve është i gabuar sepse këta e kanë konsideruar pronën tonë si pronë të Italianëve, ndërkohë që kjo nuk ka qenë për asnjë "çast" pronë e këtyre përderisa "enfiteoza" nuk e ka bërë asnjëherë shoqërinë italiane pronare të pronës tonë.

Në mbështetje të nenit 477 të K.Pr.Civile ka ushtruar kundërrekurs, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave duke kërkuar mospranimin e rekursit për këto shkaqe:

-Pretendimi i parashtruar nga pala rekursuese Ana Mitro për shkelje procedurale lidhur me trupin gjykues, nuk përbën shkelje procedurale nga ato që përbën neni 472/b dhe "c" i K.Pr.Civile. Kur është shpallur trupi gjykues në seancën e datës 14 Maj 2010 pala rekursuese nuk ka parashtruar kundërshtimet e saj lidhur me pjesëmarrjen e këtij gjyqtari në proces.

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatorin Fatos Lulo, përfaqësuesen e palës paditëse av. Flutura Kokona e cila kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të

vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, përfaqësuesen e ndërhyrsave kryesorë av. Erinda Ballanca e cila kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, dëgjoi përfaqësuesin e palës së paditur juristin Andi Çuhadari i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, degjoi avokatin e shtetit Abaz Deda i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, e si shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Nga akte e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se gjykatat e faktit kanë pranuar të provuar se paditësat Ana Mitro (Veveçka), Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomani, Eleni Mima dhe ndërhyrësit kryesor Polikseni Mima dhe Marjeta Mima, janë trashëgimtarë ligjor të ish pronarëve, Jorgji Veveçka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariadhni Konomi fakt i cili vërtetohet nëpërmjet dëshmimeve të trashëgimisë ligjore nr 2049 datë 31.05.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 1134 datë 23.06.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nr. 1105 datë 17.06.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nr. 464 datë 22.11.1993 Noteria Tiranë, nr.704 datë 16.07.1993 Noteria Tiranë.

Paditësat dhe ndërhyrësit kryesorë Ana Mitro (Veveçka), Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomani, Eleni Mima, Polikseni Mima dhe Marjeta Mima, i janë drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Qarku Durrës, me kërkesë për njohjen e të drejtës së pronësisë dhe kthimin në natyrë të pronës të lënë nga trashëgimlënësit e tyre **Jorgji Veveçka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariadhni Konomi.** Zyra Rajonale e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave Durrës, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e trashëgimtarëve të ishpronarëve, fillimisht me vendimin nr 172, dt 01.08.2007, u ka pranuar atyre kërkesën për njohjen e të drejtës së pronësisë dhe u ka kthyer në natyrë sipërfaqen e tokës 157.2 ha, si dhe ka vazhduar procedurat për njohjen dhe kthimin e pjesës tjetër të pronës. Zyra Qëndrore e Agjensisë së Kthimit të Pronave, pasi ka shqyrtuar me inisiativën e saj vendimin nr. 172 dt 01.08.2007 të Z.R.K.K.Pronave Durrës, me vendimin nr. 258 dt 01.10.2007 e ka shfuqizuar vendimin nr. 172 dt 01.08.2007 dhe ka kthyer dosjen për shqyrtim duke i lënë si detyra Z.R.K.K.P. Durrës, të verifikojë korrespondencën me Ministrinë e Mjedisit.

Në rishqyrtim i padituri, me vendimet nr. 379; 380; 384, ka rrëzuar kërkesën e trashëgimtarëve të ish-pronarëve Jorgji Veveçka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariadhni Konomi, për njohjen e të drejtës së pronësisë dhe kthimin në natyrë të pronës së trashëgimlënësve të tyre, konkretisht:

1- Me vendimin nr. 380 dt. 28.12.2007, të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarku Durrës lënë në fuqi me vendimin nr. 1069 dt. 24.09.2008 të Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Tiranë është vendosur: *“Mos njohja e të drejtës së pronësisë trashëgimtarëve të subjekteve pretendues si të shpronësuara Jorgji Veveçka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariandhi Konomi, që dalin nga dëshmitë e trashëgimive të dhëna në pikën 3 të të këtij vendimi, për pronën me sipërfaqe 1 820 000 m2 e ndodhur në fshatin Hamallaj (sektor) të rrethit të Durrësit në ZK 1925, me indeks hartë K-34-88-(144-B, 146-A, 129-D, 161-B) me këto kufij: Veriu pas. Nr. 49, 54/2, 133/2 e kanali i hidrovorit; Jug –vija ndarëse midis fshatit Rushkull-Hamllaj (sektor) Perëndim –pasuria nr. 21/8, 21/6, Lindje -pas. Nr.133/2, 49, 139, 146, 87, për faktin se këta trashëgimtarë nuk legjitimohen si palë në procesin administrativ për mangësitë e dala në pjesën përshkruese të vlerësimit ligjor që ndodhet në dosje.”*

2- Me vendimin nr. 379 dt. 28.12.2007 të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarku Durrës lënë në fuqi me vendimin nr. 1071 dt. 24.09.2008 të Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Tiranë është vendosur: *“Mos njohja e të drejtës së pronësisë trashëgimtarëve të subjekteve pretendues si të shpronësuara Jorgji Veveçka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariandhi Konomi, që dalin nga dëshmitë e trashëgimive të dhëna në pikën 3 të këtij vendimi, për pronën me sipërfaqe 25 597 200m2 e ndodhur në fshatin Rrushkull ne ZK 3241, me indeks hartë të papërcaktuar, pasi zona është jashtë sistemit të ZVRPP Durrës me këto kufij natyralë: Veriu Prona e vet, Jug-Lumi Erzen, Perëndim Deti, Lindje Qani Hanëm dhe Fuat Bej Toptani për faktin se, këta trashëgimtarë nuk legjitimohen si palë në procesin administrativ për mangësitë e dala në pjesën përshkruese të vlerësimit ligjor që ndodhet në dosje.”*

3-Me vendimin nr. 384 dt. 04.01.2008 të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarku Durrës lënë në fuqi me vendimin nr. 1070 dt. 24.09.2008 të Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Tiranë është vendosur: *“Mos njohja e të drejtës së pronësisë trashëgimtarëve të subjekteve pretendues si të shpronësuara Jorgji Veveçka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariandhi Konomi, që dalin nga dëshmitë e trashëgimive të dhëna në pikën 3 të të këtij vendimi, për pronën me sipërfaqe 1 575 900m2 e ndodhur në fshatin Hamallaj (sektor) të rrethit të Durrësit në ZK 1925, me indeks hartë K-34-88-(144-B, 129-A, 129-B) me këto kufij: Veriu pas. Nr.20/1, 21/9; Jug –vija ndarëse midis fshatit Rrushkull, Perëndim –deti, Lindje -pas. Nr.21/9, 21/10,*

I 34 pasi këta trashëgimtarë nuk legjitimohen si palë në procesin administrativ për mangësitë e dala në pjesën përshkruese të vlerësimit ligjor që ndodhet në dosje.”

Nga përmbajtja e vendimeve të kundërshtuara, rezulton se nga ana e të paditurit Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarku Durrës është arritur në konkluzionin se:

-Paditësit nuk rezultojnë të kenë gëzuar titullin e pronësisë të vetëm ose në bashkëpronësi për pronën e pretenduar.

-E gjithë prona rezulton në emër të zj Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo dhe i është dhënë me enfiteozë për 99 vjet shoqërisë E.I.I.A. në vitin 1940 dhe më pas është sekuestruar nga shteti shqiptar në 29.05.1945 kësaj shoqërie.

-Ankimuesit në asnjë rast nuk figurojnë pronar ose bashkëpronar.

-Vendimi i Gjykatës Durrës nr. 52 dt. 02.03.1946 i cili ka konsideruar të pavlefshëm testamentin e lënë nga Miltiadh Shallvari në favor të Znj Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo dhe ka vendosur të njohë si bashkëpronar Znj Maria Ljubica Shallvari, Jorgji Veveçka Sofia Kolea Kostandin Mima Evdhoqes Goxhomani, Ariandhi Konomi sipas pjesëve takuese, nuk është transkriptuar në regjistrat e hipotekës së asaj kohe e për pasojë nuk i ka sjellë efektet e veta juridike.

Bazuar në këtë arsyetim nga ana e të paditurit, Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarku Durrës dhe te Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Tiranë është rrëzuar kërkesa e paditësave, pasi sipas të paditurit nuk legjitimohen të iniciojnë një procedurë administrative.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, të dyja gjykatat e faktit kanë arritur në përfundimin se rezulton e provuar se në këto nota transkriptimi të viteve 1919-1946, përcaktohet shprehimisht se, kufizimet e pronës “Çifliku Rrushkull dhe Çifliku i Ri” janë: *L - çifliku në posedim të shoqërisë E.I.I.A, duke u ndarë me të me shtylla çimentoje, të vendosura ndërmjet dy pronave gjatë gjithë çiflikut, prej Erzenit, në vendin Shena Prende të Kulla; J - lumi Erzen; P - Deti Adriatik; V- pronat e Qanie Libohovës, Zija Toptanit, Fuat Toptanit, Ali Qoraliut dhe prej këtyre me një hendek, prej vendit Kulla, der tek ai i quajtur Tana, pastaj prej lumit Vorbe, e më tutje nga Tarini dhe pastaj shtrihet deri në vendin e quajtur Shën Pjetri, kufij të konfirmuara nga tapit e ishpronarit Miltjadh Shallvari prej kadastrës së Durrësit e Shijakut, në dat/ 19.08.1919.*

Rezulton e provuar që trashëgimlënësi Miltiadh Shallvari ka vdekur me 17.05.1933.

Nga rregjistri i pasurive të paluajtshme rezulton që në vitin 1940, në volumn 11 rep. me nr. rendor 527 faqe 32 vol 12 dosje artikull 117, kjo pronë është transkriptuar në favor të Znj Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo, sipas një testamenti të lënë nga trashëgimlënësi Miltiadh Shallvari në datë 08.05.1929.

Nga rregjistri i pasurive të paluajtshme rezulton se me nr. rendor 528 viti 1940 është rregjistruar heqja dorë (renoncimi) i Edita Shallvarit e bija e trashëgimlënësit Miltiadh Shallvari dhe Nikolo Shallvari vëllai i trashëgimlënësit Miltiadh Shallvari nga çdo lloj e drejtë që mund tu takojë për efekt trashëgimie mbi pronat Rrushkull dhe Cifliku i Ri, në favor të Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo.

Në datë 27.04.1940, është rregjistruar në rregjistrat e pasurive të paluajtshme Durrës një kontratë enfiteoze kundër Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo në favor të shoqërisë italiane E.I.I.A.

Me notën e transkriptimit nr 126, volumni 15, date 29.05.1946, në favor të shtetit shqiptar kundra shoqërisë italiane E.I.A.A. rezulton se, prona e mësipërme me kufizimet: V - Ali Bej Qorralliu, Fuat Bej Toptani, Zija Bej Toptani; P- Deti; J-lumi Erzen dhe L-Qanie Hanemi, Fuat Bej Toptani, në emër të Sllava Maria Ljubicës, dhe që ishte marë në enfiteozë nga shoqëria Italiane, kalon në favor të shtetit Shqiptar, si pronë e konfiskuar në zbatim te ligjit nr.36 dt.14.01.1945 “Mbi konfiskimin e pasurive të shtetasve italianë dhe gjermanë të ndodhura në Shqipëri”.

Duke mos qenë dakort me testamentin dhe disponimin e bërë nga i ndjeri Miltiadh Shallvari, trashëgimlënësit e paditësave, konkretisht **Jorgji Veveçka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqi Goxhomani dhe Ariadhni Konomi**, e kanë kundërshtuar testamentin dhe disponimin e bërë, nga i ndjeri Miltiadh Shallvari në favor të ish- bashkëshortes së tij Sllava Maria Ljubica Lampo, duke **ngritur padi në Gjykatën e Paqit Durrës që në vitin 1934, gjykim i cili ka vazhduar e përfunduar me vendimin nr 52, dt 03.02.1946.**

Me vendimin gjyqësor nr.52 dt.02.03.1946 i Gjyqit Civil të Prefekturës së Durrësit i formuem me Kolegj Arbitrar, Evdhoqi Goxhomani dhe Ariadhni Konomi, janë njohur bashkëpronar mbi pronën “Çifliku Rrushkull dhe Çifliku i Ri”, së bashku me ish-bashkëshorten e të ndjerit Miltiadh Shallvari, duke u përcaktuar edhe pjesët përkatëse të sejcilit bashkëpronar. Në pjesën arsyetuese të vendimit rezulton se, prona nuk ka qenë e Miltjadh Shallvarit, por e të atit të tij z.Kostandin Shallvari. Gjithashtu rezulton se, **testamenti në favor të**

bashkëshortes Sllava Maria Ljubica, është i pavlefshëm dhe pa pasoja juridike.

Pavarësisht se pranuan të provuara të njëjtat rrethana fakti dhe ligjore, dy gjykatat e faktit gjatë shqyrtimit të çështjes konkrete arritën në përfundime të ndryshme në lidhje me zgjidhjen e themelit të mosmarrëveshjes. Kështu në vendimin përkatës të saj, gjykata e shkallës së parë Durrës vendoi pranimin e padisë së paditësave dhe ndërhyrësve kryesorë duke argumentuar se paditësat Ana Mitro (Veveçka), Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomani, Eleni Mima dhe ndërhyrësit kryesor Polikseni Mima dhe Marjeta Mima, janë trashëgimtar ligjor të ish pronarëve, Jorgji Veveçka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariadhni Konomi dhe konkretisht: 1- Ana Mitro (Veveçka) dhe Pinellopi Samara (Veveçka) trashëgimtarë ligjorë të Jorgji Veveçkës. 2- Fotaq Konomi, Milika Pjero, Nikollaq Konomi, Agallia Konomi dhe Androniqi Konomi trashëgimtarë ligjore të Ariadhni Konomit. 3- Vasillaq Goxhomani, Drita Goxhomani trashëgimtarë ligjore të Evdhoqes Goxhomani. 4- Eleni Mima, Polikseni Mima, Marjeta Mima, Emi Mima, Ravik Mima trashëgimtarë ligjorë të Kostandin Mimes.

Këta trashëgimtarë janë njëkohësisht, edhe trashëgimtarë ligjorë të Sofija Koleas, dhe si të tillë ata legjitimohen në bazë të nenit 32/a të K.Pr.Civile për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që u është shkelur, për të provuar përpara gjykatës se ata kanë patur në pronësi, prona të cilat përfshihen nga zbatimi i ligjit 9235 dt. 29.07.2004 i ndryshuar. Pra, kanë patur cilësinë si ish-pronar dhe se kjo pronë iu është marrë sipas akteve ligjore dhe nënligjore, vendimeve penale të gjykatave ose marrë me çdo mënyrë tjetër nga shteti datë 29.11.1944.

Në vijim të arsyetimit të saj, nisur nga argumentat e përdorura nga pala e paditur në nxjerrjen e vendimeve përkatëse, objekt gjykimi, të paraqitura dhe në formën e prapësimeve gjatë gjykimit, gjykata e shkallës së parë Durrës shprehet se sipas ligjit nr. 66 datë 18.05.1945 "Mbi përfundimin me anë arbitrazhi të detyruar të çështjeve civile të varura pranë ish gjykatave", ne nenin 10 të tij rezulton se, afati i apelit kundër vendimit të kolegjit arbitror është 10 ditë nga shpallja. Nga kqyrja e regjistrave të apeleve, pranë arkivës së Gjykatës Durrës, të periudhës përkatëse rezulton se, kundër këtij vendimi nuk është paraqitur ankim. Gjithashtu, sipas kësaj gjykate, nuk rezulton që të ketë shënime mbi këtë vendim për veprime të mëtejshme, apo gjykime të mëtejshme. Në mungesë të ankimit rezulton e provuar që ky vendim është i formës së prerë.

Gjykata e Shkallës së Parë Durrës duke iu referuar vendimit gjyqësor të lartpërmendur ka argumentuar se vendimi gjyqësor i formës së prerë ka fuqi për të gjithë institucionet, palët ndërgjyqëse dhe për ata që marrin të drejta prej tyre. Vendimi gjyqësor nuk është veprim juridik. Nga ana e të paditurit Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Qarku Durrës dhe Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Tiranë është ngatërruar konceptim i veprimit juridik për kalimin e pronësisë me vendimin gjyqësor, ka konstatuar kjo gjykatë. Efektet e një vendimi gjyqësor fillojnë në momentin që vendimi merr formë të prerë dhe ato humbasin në rast se ky vendim prishet ose ndryshohet nga gjykatat më të larta. Në kushtet kur rezulton e provuar se ky vendim gjyqësor nuk është ankimuar, ai është i formës së prerë. Ky vendim i ka të gjitha efektet që ligji i jep vendimeve gjyqësore. Në këto kushte gjykata e shkallës së parë ka çmuar si të provuar se, bashkëzotënues në çiflikun Rrushkull të Shijakut janë Maria Lubica Shallvari, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, trashëgimtarët e Evdhoqes Goxhomani, Ariandhi Konomi, sipas pjesëve përkatëse të tyre të përcaktuar në vendimin gjyqësor nr. 52 dt. 02.03.1946 i Gjyqit Civil të Prefekturës së Durrësit i formuem me Kolegj Arbitrar. Po ashtu, nisur nga vendimi gjyqësor nr. 52 dt. 02.03.1946 i Gjyqit Civil të Prefekturës së Durrësit i formuem me Kolegj Arbitrar, është pranuar e provuar se testamenti i lënë prej trashëgimlënësit Miltiadh Shallvari në favor të bashkëshortes Sllava Maria Lubica, është deklaruar i pavlefshëm, pasi në çastin e përpilimit të tij, testatori ka qenë në paaftësi mendore për të disponuar me testament. Në kushtet e mësipërme, sipas kësaj gjykate, pasuria e tij nuk mund t'i nënshtrohej trashëgimisë testamentare, por asaj ligjore. Duke qenë se trashëgimlënësi Miltiadh Shallvari ka vdekur në vitin 1933 atëherë bashkëzotënuesit Maria Lubica Shallvari, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, trashëgimtarët e Evdhoqes Goxhomani, Ariandhi Konomi, sipas pjesëve përkatëse të tyre kanë fituar pronësinë, që në momentin e çeljes së trashëgimisë, në çastin e vdekjes së trashëgimlënësit Miltiadh Shallvari, në vitin 1933 dhe jo në datën e marrjes formë të prerë të vendimit. Gjithashtu, duke fituar pronësinë trashëgimtarët kanë fituar edhe posedimin e kësaj pasurie, pavarësisht se nuk e kanë shtënë në dorë efektivisht atë. Ky është një lloj posedimi i veçantë, i njohur vetëm në rastin e trashëgimisë, ku trashëgimtarët fitojnë posedimin në çastin e vdekjes së trashëgimlënësit, pavarësisht faktit nëse e kanë shtënë në dorë ose jo pasurinë efektivisht. Posedimi është një nga tagrat e pronarit. Meqënëse pronësia e fituar për shkak të trashëgimisë, fitohet në çastin e çeljes së trashëgimisë, edhe posedimi fitohet në këtë çast. Në nenin 653 të Kodit Civil të vitit 1929 parashikohet shprehimisht se: "*Posedimi i pasunisë së të vdekurit shkon ipso jure në personin e trashëgimtarit, pa qenë nevoja me i vu dorë materialisht asaj pasurie*". Sipas gjykatës së shkallës së parë Durrës, edhe ligji 9235 dt.29.07.2004, "Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave" i ndryshuar, nuk e lidh

asnjëherë njohjen, kthimin apo kompesimin e pronës me faktin nëse pretenduesit ish-pronarë e kanë poseduar apo jo pronën. Është e pamundur që ish-pronare të pronave me sipërfaqe të madhe të posedonin vetë pronën, kjo provon edhe njëherë faktin se konkluzioni i të paditurit është i gabuar. Mbi këtë arsytim, trashëgimlënësit Maria Lubica Maria Lampo, Jorgji Veveçka, Sofia Kolea, Kostandin Mika, trashëgimtarët e Evdhoqes Goxhomani, Ariandhi Konomi, janë bashkëzotenues mbi objektin çifliku Rrushkull, i cili është i përcaktuar në objektin e padisë, pra kanë pasur një pronë e cila deri me 29.11.1944 nuk rezulton të jetë shitur apo tjetërsuar prej tyre. Ky fakt vërtetohet edhe nga nota e transkriptimit të hipotekës Durrës, nr 126, dt 29.05.1946, ku prona e mësipërme e cila ishte marrë në enfiteozë nga shoqëria EIIA, prej znj.Sllava Maria Lubica Lampo, konfiskohet dhe kalon në favor të shtetit Shqiptar.

Në lidhje me faktin se pasuria në fjalë i është dhënë në enfiteozë një shoqërie italiane, në emër të së cilës është bërë dhe shpronësimi, gjykata e shkallës së parë Durrës ka konstatuar se është e vërtetë që nga ana e njërit prej bashkëzotënuesve (bashkëpronarëve) Maria Ljubica Shallvari është lidhur një kontratë enfiteoze me shoqërinë italiane EIIA, por kjo kontratë nga vetë përmbajtja e saj rezulton të jetë nul, duke qenë se njërës prej palëve i ka munguar cilësia e pronares së ligjshme, për të lidhur këtë kontratë. Sipas kësaj gjykate, përveç sa më sipër kontrata e enfiteozës, nuk është kontratë që ka për qëllim kalimin e pronësisë, por ajo ka për qëllim zhvillimin e pronës. Pronësia e sendit të paluajtshëm mbetet e enfiteozëdhënësit. Në nenin 1530 të Kodit Civil të vitit 1929 (i cili ka qenë në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës së enfiteozës), parashikohet se: *“Enfiteozi asht një kontratë, me të cilën i koncedohet një personi (enfiteozmarësi), një pronë, me detyrimin që ta përmisojë dhe të paguaj një prestim të përvitshëm, që quhet kanon dhe që caktohet në të holla ose drithna”*. Neni 1532 po i Kodit Civil të vitit 1929 parashikon se: *“Enfiteosi mund të lidhet vleftësisht vetëm prej atyne që kanë të drejtë tjetërsimi edhe me ato kondita dhe forma që lypen për tjetërsimin”*. Pra, gjykata çmon se është tërësisht e provuar, cilësia si pronare mbi sendin objekt kërkimi deri me 29.11.1944 i trashëgimlënësve të paditësave. Nga ana e të paditurit është argumentuar se pasuria e kërkuar është sekuestruar si pasuri e shtetasve italianë. Ky fakt, pra sekuestrimi i pasurisë objekt gjykimi si rezultat i zbatimit të këtij ligji, arsyeton gjykata, nuk dëshmon që sekuestrimi ka qenë i drejtë. Sipas gjykatës, shoqëria italiane EIIA nuk ka qenë pronare e pronës Çifliku Rrushkull dhe Çifliku i ri, por ka qenë vetëm enfiteozmarëse. Në nenin 2 të ligjit 9235 dt. 29.07.2004, ”Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave” i ndryshuar, cilësohet se: legjitimohen të kërkojnë kthimin apo kompesimin e pronës ish-pronarët që prona *“iu është marrë sipas akteve ligjore dhe nënligjore, vendimeve penale të gjykatave ose marrë me çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga shteti nga datë*

29.11.1944.” Pra, edhe sipas argumentit të përdorur nga i padituri, gjykata ka konstatuar se marrja e pronës në bazë të një ligji, të dalë pas datës 29.11.1944 nuk i pengon paditësat të kërkojnë pronën e tyre. Ka rezultuar për gjykatën se prona objekt kërkimi nuk është vetëm e shtetasve italiane Maria Ljubica, por edhe e Jorgji Veveçka, Sofia Kolea, Kostandin Mika, trashëgimtarët e Evdhoqes Goxhomani, Ariandhi Konomi, të cilët e kanë fituar të drejtën e tyre të pronësisë që në vitin 1933. Në këto kushte ky ligj nuk i shtrin efektet mbi pronën e shtetasve shqiptarë të cituar më lart. Në vijim të argumentit të saj ligjor, gjykata e shkallës së parë ka gjetur të provuar se prona e paditësve është marrë nga shteti në bazë të reformës agrare në zbatim të ligjit nr 108 dt. 29.08.1945, dhe ky fakt provohet edhe nga vendimi gjyqësor nr. 52 datë 02.03.1946 i Gjyqit Civil të Prefekturës së Durrësit i formuem me Kolegj Arbitrar i Gjykatës së Durrësit. Kjo gjykatë në pjesën e dispozitivit citon se: **“Ky vendim nuk mund të regjistrohet në hipotekë për shkak të veprimit të reformës agrare”**. Pra, për shkak të zbatimit mbi këtë pronë të ligjit nr. 108 dt. 29.08.1945 “Mbi reformen agrare”, vendimi është i parregjistrueshëm në rregjistrat e pasurive të paluajtshme, dhe kjo është e bazuar në nenin 1 të ligjit nr. 108. Duke qenë se prona plotësonte kushtet e përcaktuara në këtë ligj, ajo quhej e “shpronësuar” dhe u ndahej gratis bujqve sipas përcaktimeve të nenit 8 e vijues të këtij ligji, të cilët bëheshin zotues të pronës së përfiturar. Gjykata e shkallës së parë Durrës, nisur nga këto rrethana fakti dhe juridike të gjetura si të provuara, arsyetimin e saj e mbështet dhe në përmbajtjen e vetë vendimit gjyqësor nr.52 datë 02.03.1946 i Gjyqit Civil të Prefekturës së Durrësit, ku është njohur se prona trashëgimtarëve të Miltiadh Shallvarit i është marrë në zbatim të ligjit nr. 108 dt. 29.08.1945, “Mbi reformen agrare” dhe jo me ndonjë ligj tjetër.

Në lidhje me faktin se cila pjesë e pronësisë së mësipërme do të duhet të konsiderohet si e lirë për efekt të zbatimit të legjislacionin për kthimin dhe kompensimin e pronës, Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka administruar në cilësinë e provës një akt ekspertimi për vendndodhjen e sipërfaqjes dhe regjimin juridik të tyre. Pas shqyrtimit të këtij akti në seancë gjyqësore dhe duke interpretuar përmbajtjen e nenit 6 dhe 7 të ligjit nr. 9235, dt 29.07.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave”, gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin se sipërfaqja që u duhet kthyer subjekteve të gjykimit nuk është objekt i kufizimeve të vëna nga ligjvënësi në dispozitat e mësipërme. Në dispozitivin e vendimit të saj, gjykata e shkallës së parë Durrës, vendosi pranimin e padisë, duke disponuar sipas objektit të kërkimit.

Sikundër u parashtrua më lart në këtë vendim, Gjykata e Apelit Durrës, pavarësisht se pranoi të provuar të njëjtat rrethana fakti, arsyetimi juridik i saj

rezulton të jetë i kundërt në lidhje me bazueshmërinë në ligj të kërtimeve të palës paditëse dhe ndërhyrësve kryesore. Kështu në vendimin e gjykatës së apelit Durrës është argumentuar se me ligjin nr.12 dt.21/10/1943 të Këshillit Ekzekutiv (pasi në atë kohë nuk funksiononte parlamenti deri në janar 1944) është vendosur sekuestrimi i pasurive të shoqërive italiane E.I.A.A. dhe AGIP, fakt që provon se kjo pronë e dhënë nga Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo, me enfiteozë shoqërisë italiane E.I.A.A. ishte sekuestruar nga shteti shqiptar që në vitin 1943. Ndërkohë, gjykata e apelit konstaton se me notën e transkriptimit nr.126 vol.15, dt.29/05/1946, prona e dhënë me enfiteozë shoqërisë italiane E.I.A.A. rikonfirmohet se kalon përseri në favor të shtetit shqiptar. Ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit nuk ka konsideruar si të mirëqenë faktin se vendimi nr.52 dt.02/03/1946, ka konsideruar të pavlefshëm testamentin e lënë nga z.Miltiadh Shallvari në favor të zj.Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo dhe ka vendosur të njohë si bashkëpronar zj.Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo, me Jorgji Vevecka, Sofie Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariadhni Konomi. Sipas gjykatës së apelit, rezulton se ky vendim nuk është regjistruar në regjistrat e hipotekës së asaj kohe, nuk ka marrë formë të prerë, nuk është i nënshkruar nga gjyqtari i çështjes dhe sekretarja e çështjes dhe për pasojë nuk ka sjellë efektet e veta juridike. Në bazë të ligjit nr.108 dt.29/08/1945 për reformën agrare, gjykata e apelit arrin në përfundimin se kjo pronë nuk i është marrë trashëgimlënësve të paditësve, por personave që rezultonin pronarë në zyrën e hipotekës. Procesi gjyqësor i zhvilluar në vitin 1946, është zhvilluar nga palë të cilët nuk kanë qenë pronarë të pronës pasi de facto ishte marrë nga reforma agrare dhe as posedues të pronës e për pasojë ka qenë një veprim fiktiv dhe pa pasoja gjë që ka bërë të mospasqyrohet në regjistrat përkatës. Sipas gjykatës së apelit, gjykata në vendimin përkatës në mënyrë të paligjshme ka shpronësuar shtetin duke njohur pronarë të rinj pasi bazuar në ligjin "Mbi aplikimin e K.Civil" të vitit 1929, kaptina II, neni 55, është përcaktuar se: "Një tokë rurale në asnjë rast nuk mund të mbetet më tepër se 7 vite në dorën e të huajve me të drejtë zotërimi edhe sikur brenda këtij afati të jetë trashëgue shumë herësh mes të huajsh", fakt i cili cilësohet edhe në nenet 54 e 56. Bazuar në testamentin e datës 08/05/1929, pas vdekjes së testatorit Miltiadh Shallvari më dt.17/05/1933, prona ka kaluar në pronësi të shtetates së huaj Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo. Në këto rrethana, sipas gjykatës së apelit, në vitin 1940 prona në bazë të ligjit të mësipërm ka qenë shtetërore, për rrjedhojë përsa kohë që trashëgimlënësit e paditësve nuk kanë bërë gjyq me pronarin shtet edhe teorikisht nuk mund të bëhen pronarë. Kjo është arsya që shteti shqiptar ia ka marrë direkt shoqërisë E.I.A.A. pasi në atë kohë ai ishte vetë pronar i asaj prone në bazë të ligjit dhe nuk njihete pronarët e mëparshëm zj.Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo.

hollësi të gjitha provat e administruara në procesin gjyqësor.

Kolegji Civil vlerëson të parashtrojë se në dispozitën e nenit 2/1, të ligjit nr. 9235, dt 29.07.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave”, ligjvënësi ka parashikuar: *“Çdo subjekt i shpronësuar ka të drejtë të kërkojë, në përputhje me këtë ligj, të drejtën e pronësisë, në rast se i është hequr sipas akteve ligjore, nënligjore, vendimeve penale të gjykatave ose të marrë me çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga shteti nga data 29.11.1944, si dhe kthimin ose kompensimin e pronës.”*

Në vijim të kësaj normative ligjore, në nenin 3/3 është sanksionuar se: *“Subjekt i shpronësuar” nënkupton personat juridikë ose fizikë apo trashëgimtarët e tyre, prona e të cilëve është shtetëzuar, shpronësuar, konfiskuar ose e marrë me çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga shteti;”*.

Përmbajtja dhe interpretimi i saktë i këtyre dispozitave ligjore ka një rëndësi të posaçme gjatë shqyrtimit gjyqësor të mosmarrëveshjeve që lindin për shkak të zbatimit të ligjit të lartpërmendur nga ana e strukturave përkatëse të administratës publike.

Sikundër me të drejtë ka arsyetuar Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, sipërfaqjet e trajtuara në dispozitivin e vendimit të kësaj gjykate, bëjnë pjesë në rrethin e sendeve për të cilat zbatohen dispozitat e nr. 9235, dt 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e Pronave”. E drejta e pronësisë në rastin konkret, subjektit pronar, rezulton t’i jetë hequr nga shteti nëpërmjet shtetëzimit arbitrar (të padrejtë), pa

rezulton të jetë i kundërt në lidhje me bazueshmërinë në ligj të kërkimeve të palës paditëse dhe ndërhyrësve kryesore. Kështu në vendimin e gjykatës së apelit Durrës është argumentuar se me ligjin nr.12 dt.21/10/1943 të Këshillit Ekzekutiv (pasi në atë kohë nuk funksiononte parlamenti deri në janar 1944) është vendosur sekuestrimi i pasurive të shoqërive italiane E.I.A.A. dhe AGIP, fakt që provon se kjo pronë e dhënë nga Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo, me enfiteozë shoqërisë italiane E.I.A.A. ishte sekuestruar nga shteti shqiptar që në vitin 1943. Ndërkohë, gjykata e apelit konstaton se me notën e transkriptimin nr.126 vol.15, dt.29/05/1946, prona e dhënë me enfiteozë shoqërisë italiane E.I.A.A. rikonfirmohet se kalon përseri në favor të shtetit shqiptar. Ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit nuk ka konsideruar si të mirëqenë faktin se vendimi nr.52 dt.02/03/1946, ka konsideruar të pavlefshëm testamentin e lënë nga z.Miltiadh Shallvari në favor të zj.Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo dhe ka vendosur të njohë si bashkëpronar zj.Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo, me Jorgji Vevecka, Sofie Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariadhni Konomi. Sipas gjykatës së apelit, rezulton se ky vendim nuk është regjistruar në regjistrat e hipotekës së asaj kohe, nuk ka marrë formë të prerë, nuk është i nënshkruar nga gjyqtari i çështjes dhe sekretarja e çështjes dhe për pasojë nuk ka sjellë efektet e veta juridike. Në bazë të ligjit nr.108 dt.29/08/1945 për reformën agrare, gjykata e apelit arrin në përfundimin se kjo pronë nuk i është marrë trashëgimlënësve të paditësve, por personave që rezultonin pronarë në zyrën e hipotekës. Procesi gjyqësor i zhvilluar në vitin 1946, është zhvilluar nga palë të cilët nuk kanë qenë pronarë të pronës pasi de facto ishte marrë nga reforma agrare dhe as posedues të pronës e për pasojë ka qenë një veprim fiktiv dhe pa pasojë gjë që ka bërë të mospasqyrohet në regjistrat përkatës. Sipas gjykatës së apelit, gjykata në vendimin përkatës në mënyrë të paligjshme ka shpronësuar shtetin duke njohur pronarë të rinj pasi bazuar në ligjin "Mbi aplikimin e K.Civil" të vitit 1929, kaptina II, neni 55, është përcaktuar se: "Një tokë rurale në asnjë rast nuk mund të mbetet më tepër se 7 vite në dorën e të huajve me të drejtë zotërimi edhe sikur brenda këtij afati të jetë trashëgue shumë herësh mes të huajsh", fakt i cili cilësohet edhe në nenet 54 e 56. Bazuar në testamentin e datës 08/05/1929, pas vdekjes së testatorit Miltiadh Shallvari më dt.17/05/1933, prona ka kaluar në pronësi të shtetates së huaj Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo. Në këto rrethana, sipas gjykatës së apelit, në vitin 1940 prona në bazë të ligjit të mësipërm ka qenë shtetërore, për rrjedhojë përse kohë që trashëgimlënësit e paditësve nuk kanë bërë gjyq me pronarin shtet edhe teorikisht nuk mund të bëhen pronarë. Kjo është arsya që shteti shqiptar ia ka marrë direkt shoqërisë E.I.A.A. pasi në atë kohë ai ishte vetë pronar i asaj prone në bazë të ligjit dhe nuk njihete pronarët e mëparshëm zj.Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo.

plotë por i pjesshëm (restitutio in parte).” Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmon se gjykata e shkallës së parë Durrës, në përputhje me përmbajtjen e dispozitës së nenit 310 të K.Pr.Civile, ka marr një vendim bazuar në ligj e duke analizuar me hollësi të gjitha provat e administruara në procesin gjyqësor.

Kolegji Civil vlerëson të parashtrojë se në dispozitën e nenit 2/1, të ligjit nr. 9235, dt 29.07.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave”, ligjvënësi ka parashikuar: *“Çdo subjekt i shpronësuar ka të drejtë të kërkojë, në përputhje me këtë ligj, te drejtën e pronësisë, në rast se i është hequr sipas akteve ligjore, nënligjore, vendimeve penale të gjykatave ose të marrë me çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga shteti nga data 29.11.1944, si dhe kthimin ose kompensimin e pronës.”*

Në vijim të kësaj normative ligjore, në nenin 3/3 është sanksionuar se: *“Subjekt i shpronësuar” nënkupton personat juridikë ose fizikë apo trashëgimtarët e tyre, prona e të cilëve është shtetëzuar, shpronësuar, konfiskuar ose e marë me çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga shteti;”*.

Përmbajtja dhe interpretimi i saktë i këtyre dispozitave ligjore ka një rëndësi të posaçme gjatë shqyrtimit gjyqësor të mosmarrëveshjeve që lindin për shkak të zbatimit të ligjit të lartpërmendur nga ana e strukturave përkatëse të administratës publike.

Sikundër me të drejtë ka arsyetuar Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, sipërfaqjet e trajtuara në dispozitivin e vendimit të kësaj gjykate, bëjnë pjesë në rrethin e sendeve për të cilat zbatohen dispozitat e nr. 9235, dt 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e Pronave”. E drejta e pronësisë në rastin konkret, subjektit pronar, rezulton t’i jetë hequr nga shtetipërmjet shtetëzimit arbitrar (të padrejtë), pa patur subjekti pronar ndonjë detyrim të ligjshëm, në zbatim të së cilit e drejta e pronësisë mund t’i kalonte shtetit në përputhje me dispozitat e ligjit material civil.

Në rastin konkret, me të drejte Gjykata e Shkallës së Parë Durrës duke bërë një renditje kronologjike të origjinës së pronësisë dhe kalimit të titullit të pronësisë ndër vite mes subjekte të ndryshëm, gjithmonë të lidhur në gjini me pronarin e parë Miltiadh Shallvari dhe atin e tij, ka konkluduar se në momentin e shtetëzimit të pronës, ajo (prona) nuk ka patur asnjë pronar tjetër përveç pjestarëve të familjes Shallvari dhe subjekteve të tjerë të lidhur me të. Fakti se akti përkatës i shtetëzimit ka dalë në emër të shoqërisë italiane, shoqërisë italiane E.I.I.A., nuk do të thotë se titulli i pronësisë i përkiste kësaj të fundit.

Sikundër është provuar gjatë shqyrtimit gjyqësor në asnjë rast, shoqëria italiane E.I.I.A. nuk ka patur ndonjë titull pronësie mbi sipërfaqjet e pronës të shtetëzuar. Kjo sipërfaqje i është dhënë shoqërisë italiane E.I.I.A. në posedim nëpërmjet një kontrate enfiteoze, kontratë kjo që me të drejtë është konstatuar se asnjëherë nuk mund të pretendohet të përbëjë titull pronësie. Pra, pavarësisht se akti administrativ i shtetëzimit, pasqyron shtetëzimin e pronës kundër shoqërisë italiane E.I.I.A., kjo e fundit nuk e gëzon cilësinë e kërkuar nga neni 2/1 i ligjit nr. 9235, dt 29.07.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave”, duke qenë se këtë cilësi e ka vetëm pronari i sendit.

Në cilësinë e pronarit të sendit, me të drejtë Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka evidentuar fillimisht shtetasin Miltiadh Shallvari. Me vdekjen e këtij të fundit rezultoi se prona i kaloi të vesë së tij, shtetasës së huaj Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo, nëpërmjet trashëgimisë testamentare. Ky titull pronësie rezultoi se në vijim u bë objekt i goditjes gjyqësore nga subjekte të tjera që lidheshin në rrugë gjinore me shtetasin Miltiadh Shallvari. Duke qenë se pas shqyrtimit gjyqësor është marr një vendim përfundimtar, ai nr.52, datë 02.03.1946 i Gjyqit Civil të Prefekturës së Durrësit i formuar me Kolegj Arbitrar të Gjykatës së Durrësit, ky i fundit me të drejtë është konsideruar i formës së prerë dhe me fuqi të plotë juridike mbi palët në këtë proces, palë këto që nuk e kishin humbur në asnjë rrethanë pronësinë mbi sendin deri në momentin e shtetëzimit.

Argumentimi i gjykatës së apelit se vendimi i mësipërm nuk sjell pasoja juridike është i mangët dhe jo ligjor. Në asnjë rast, vendimi gjyqësor në fjalë nuk është bërë objekt i kundërshtimit të tij për falsitet apo elemente të tjerë (fiktivitet) që ndikojnë në fuqinë juridike të tij. Në vështrim të nenit 246 e vijues të K.Pr.Civile, vendimi i mësipërm është provë e plotë për përmbajtjen e tij, në rastin konkret duke përbërë dhe aktin e njohjes së titullit e pronësisë së palës paditëse dhe ndërhyrësve kryesorë.

Në vështrim të nenit 3/3 te nr. 9235, dt 29.07.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave”, palë paditëse dhe ndërhyrësit kryesorë me të drejtë janë konsideruar si subjekte të zbatimit të ligjit të mësipërm. Ata janë trashëgimtarët ligjorë të të gjithë rrethit të bashkëpronarëve të sendit të njohur me vendimin nr.52, datë 02.03.1946 të Gjyqit Civil të Prefekturës së Durrësit, i formuar me Kolegj Arbitrar të Gjykatës së Durrësit, e në këto rrethana gëzojnë një interes të ligjshëm, interes që i legjitimon që pas ndjekjes së hierarkisë administrative për shqyrtimin e kërtimeve të tyre, t’i drejtohen juridiksionit gjyqësor, siç dhe ka ndodhur në rastin konkret.

Përsa më lart, pas konkludimit në lidhje me sipërfaqjet e lira, Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka marr një vendim të drejtë e të bazuar në ligj (neni 6 i ligjit nr. 9235, dt 29.07.2004), duke u kthyer në natyrë palës paditëse dhe ndërhyrësve kryesorë një pjesë të pronës dhe duke e kompensuar për pjesën e mbetur të saj.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 485/b të Kodit të Proçedurës Civile

V E N D O S I

Prishjen e vendimit nr.210, dt.14.05.2010, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit nr.2653, dt.05.10.2009, të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Tiranë, më 14.06.2011

A N Ë T A R
Medi BICI
(Kundër)

A N Ë T A R
Gani DIZDARI

K R Y E S U E S
Besnik IMERAJ

A N Ë T A R
Andi ÇELIKU

A N Ë T A R
Fatos LULO

Vertetohet njesia me origjinalin P drejt adm gjyq E Haxhia

SD